

Tiranë, 26.02.2023

DEKLARATË

LIDHUR ME FILLIMIN E PARAKOHSHËM TË FUSHATËS ELEKTORALE

Kodi Zgjedhor përcakton afatin kohor të fillimisht të fushatës elektorale. Sipas kalendarit aktual, fushata nis zyrtarisht më 14 prill dhe përfundon më 14 maj 2023. Pavarësisht përcaktimeve fushata de facto ka nisur prej kohësh dhe partitë janë duke zhvilluar aktivitete promovuese të kandidatëve në bashki të ndryshme.

Nga monitorimi i ISP-së rezulton se drejtuesit më të lartë të qeverisë e PS-së, drejtuesit e bashkive, drejtuesit politikë opozitës, përfshirë dy grupet në PD dhe PL, kanë zhvilluar vetëm gjatë muajit shkurt rreth 55 aktivitete me natyrë të qartë elektorale.

Në një shoqëri demokratike partitë kanë të drejtë të bëjnë aktivitete dhe të promovojnë idetë e veta, kandidatët e vet, por përcaktimi ligjor mbi periudhën e fushatës elektorale lidhet me disa detyrime:

- ➔ detyrimin për monitorim të financimit,
- ➔ detyrim për monitorim të raportimit në mediat publike/AMA,
- ➔ detyrim për monitorimin e përdorimit të burimeve shtetërore,
- ➔ detyrim për monitorimin e donacioneve dhe grupeve mbështetëse,
- ➔ detyrim për monitorimin e kandidatëve dhe të subjekteve zgjedhore,
- ➔ detyrim për monitorimin e reklamave / spoteve në media

Në kushtet aktuale, kur zyrtarisht nuk ka nisur fushata, asnjë prej këtyre elementëve nuk monitorohen, nuk raportohen dhe nuk llogariten në elementë elektorale, por de facto ato janë të tilla.

Instituti i Studimeve Politike (ISP) po monitoron sjelljen e partive dhe strukturave shtetërore në procesin elektorale. Nga kjo pozitë ISP vlerëson se fillimi i hershëm i fushatës elektorale ka cenuar parimet e mira zgjedhore dhe përbën një rast i dukshëm abuzimi nga ana e subjekteve politike kryesore.

- ISP apelon KQZ të adresojë shqetësimin tek subjektet elektorale për nevojën e respektimit të afateve ligjore për fushatën, si dhe ti trajtojë aktivitetet e tanishme si pjesë të fushatës elektorale me të gjitha detyrimet pasuese.
- ISP apelon partitë politike të bëjnë deklaram të rregullt të financimit të aktiviteteve të tyre publike, si dhe të respektojnë afatet ligjore, për të cilat vetë ato kanë votuar,
- ISP apelon qeverinë të ndalojë përdorimin e burimeve shtetërore në fushatë, duke ndërmarrë akte konkrete, si dhe ministrat, të qëndrojnë në detyrën ekzekutive në përputhje me mandatin kushtetues, duke evituar pjesëmarrjen në kohën e punës në aktivitete promovuese elektorale dhe partiake.
- ISP apelon bashkitë dhe administratën vendore të evitojnë aktivitetet me natyrë elektorale, duke respektuar parimet e Kodit Zgjedhor
- ISP apelon të gjithë aktorët vëzhgues të kryejnë monitorim edhe në periudhën aktuale paraelektorale, për t'i dhënë integritet të plotë procesit të monitorimit dhe nevojës për transparencë maksimale në procesin elektorale.

Zgjedhjet nuk janë një ditë, nuk janë vetëm akti i votimit, por janë një proces. Më shumë se emrat fitues kanë vlerë e rëndësi standardet zgjedhore, aftësia e Shqipërisë për zgjedhje me integritet dhe maturi, sfida për jetësimin e demokracisë funksionale.

Instituti i Studimeve Politike (ISP)